



**VENDIM**

*Nr.48 Datë 06.07.2009*

**PËR  
FILLIMIN PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË  
SHOQËRISË “RUNNING ENERGY” PËR KUALIFIKIMIN E  
IMPIANTEVE PRODHUES (PARKU EOLIK MASKURI) SI BURIME  
TË RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39; të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, të Vendimit të Bordit të Komisionerëve Nr. 44, datë 24.07.2007 “Për miratimin e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s,” neni 18, dhe të Vendimit të Bordit të Komisionerëve Nr.9, datë 21.02.2007 “Për miratimin e Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme”, neni 8, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.07.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “RUNNING ENERGY” për kualifikimin e impianteve prodhues (Parku eolik Maskuri) si burime të rinovueshëm energjie, dhe konstatoi rregullshmërinë e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë “RUNNING ENERGY”.

**VENDOSI :**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “RUNNING ENERGY” për kualifikimin e impianteve prodhues (Parku eolik Maskuri) si burime të rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**

**Bujar Nepravishta**